



Frazeologji gjuhësore në prozën e P. Vinçenc Prennushit

Meri Markiçi

Faculty of History and Philology, University of Tirana, Editor, Academy of Sciences of Albania, Tirana, Albania

Abstract

Në këtë artikull bëhen përpjekje të nxirret në pah pasuria e njësive frazeologjike dhe prania e tyre në prozën e poetit V. Prennushi, në mënyrë të veçantë tek dy dramet e tij: “E trathtuemja” (përshtatje nga autori T. A. Rolando) dhe krijimi tjetër, original, me titullin “Prej robnije në liri”. Kërkimi përqendrohet kryesisht në karakteristikat e prozës dramatike të Prennushit, si dhe në rolin stilistik të njësive frazeologjike që dalin përgjatë monologëve dhe dialogëve të personazheve të një veprë letrare, hartuar në variantin e shkruar të gegërishtes, me karakteristikat e të folmes së Gropës së Shkodrës. Nga ky kërkim vihet në dukje se përdorimi i këtyre njësive gjuhësore në gojën e personazheve, vjen e shfaqet sipas formimit të tyre arsimor, sipas situatave të kumtimit dhe strukturës së frazave, duke shtuar dhe ndikuar në shprehësinë e gjuhës së autorit.

Keywords: Vinçenc Prennushi, njësi frazeologjike dhe paremiologjike, E trathtuemja, Prej robnije në liri, endiada

1. Introduction Hyrje

Objekt i këtij shkrimi është prania e njësive frazeologjike të dy veprave në prozë të V. Prennushit: “E trathtuemja” dhe “Prej robnijet në liri”, duke pasur parasysh që gjuha e teatrit, apo e veprave teatrore, si një kombinim monologësh dhe dialogësh, nuk është e njëjtë as me gjuhën poetike, as edhe me gjuhën e prozës narrative-tregimtare, me të cilën thuren kallëzimi, novela dhe romani. Ky karakterizim vjen për shkak se, përveç fjalës, në skenën me lojën e aktorëve, ndërhyjnë në këtë lloj komunikimi, edhe e ashtuquajtura gjuha e trupit, gjuha e gjesteve, gjuha e mimikës, përgjithësisht kinetika kumtuese, ku *vend të parë* zë elipsa gjuhësore, pasi replikat mes personazheve, si një tendosje mesazhi nga emetuesi tek destinatori, vijnë e plotësohen, duke mbushur “vendet bosh” që lihen midis dy anëve *Emetues – Destinator*. Fjala vjen, ndodh që ndërmytet replikave të përsëriten fjalë e grupe fjalësh, edhe fjali, me qëllim theksimi e për t’u dhënë rëndësi të veçantë; ose, edhe për të shprehur habi, entuziazëm, ironi, etj., si në dialogun në vijim, (f.14-15):

Zoja e shpis –...A t’ka ndollë gjâ, a t’ka gergâ kush?

Lena – (*tuj u trimnue*) A më ka ndollë gjâ?.....

Shpesh herë, autorët e gjinisë dramatike, kanë përshkrime me fjali e fraza edhe të gjata, para se të nisin veprimet skenike dhe replikat e aktorëve.

Së dyti, plotësimet gjuhësore të elipsave (mungesave) të gjymtyrëve funksionale në strukturën fjali, realizohen prej vetë folësve nëpërmjet kinetikës, këto *gjymtime* njësisht predikative, vihen në vend edhe prej replikave nga njëri autor te tjetri. Për shembull, në melodramën “E trathtuemja”, në (f. 5), për personazhin EMA, shënohet në kllapa me shkrim italic (*ndëjë afër një tryezet, tănë trishtim*); ose në (f. 10): (*flet lët, tuj u avitë kahë Ema*); ose në (f. 13): (*Sjellë kahë vëndi kû pat dalë Elvira e tuj ju mâtë me shîs*).

E treta, në prozë, çfarëdo gjinie e lloj letrar, frazeologjizmat kanë hapësirë më të lirë dhe nuk ngjet, as lind nevoja që ato të

“shformohen”, të ndërrojnë rend gjymtyrësh, apo të marrin fjalë a toje të ndërmytuara, thënë ndryshe, ato hyjnë siç janë, të paprekura, në vijën e narracionit, përveçse kur ndodh që autorët, për arsye karakterizimi të situatës apo të personazheve, mund të vënë dorë në strukturën e tyre. Për shembull, në një replikë të Emës, gjejmë frazën: “*Lojë e kçimet e deritashme m’a kan bâ me ra disi fâsh zemren e shporueme t’êmen...*” (f.7); frazeologjizmi “*bie fashë*” – *bie në qetësi, bie në paqë*; nga një gjendje e trazuar, e shqetësuar, në këto raste ngjet që për arsye theksimi vihet në dukje masa e një gjendjeje; dhe përmiri “mund të dalë edhe pas shprehjes.” *Së katërti*, ka edhe në semantikën e njësive frazeologjike raste kur, në rrethime të caktuara sintaksore, bartin domethënie ambigue, si në shprehjen me bazë foljore “*...mûndem me t’bâ qi të bîndesh...*”, në “*Mos më trazô, po të tham, pse mûndem me të bâ qi të bîndesh edhe ti prej vedit.*” (f.13), ku folja “bind – bindem” nuk del me domethënie “i dëgjoj fjalën dikujt”, “i shtrohem një urdhri” etj.; por mban kuptimin “çudit”, “të lë me gojë hapët”.¹ Fjalori që cituam, përmban edhe temën “bind-i” (em) – *çudi, mrekuilli; për çudi*; bashkë me fjalët a grupet e fjalëve që i quajtmë “rrethim sintaksor” (konteksti), ndjekim semantikën dhe dalim në kuptimin “të bëj të çuditësh, të bindesh, të mrekuillohesh” etj.

E pesta, gjejmë modele dialogu në dramet e Prennushit, ku replikat vijnë e plotësojnë njëra-tjetrën, me një fjalë, *fjalitë e paplota*, si në shembullin e personazheve në vijim, ku njësitë mbështesin njëra-tjetrën:

A f r a – Kish t’a dijshe se çka fiton ti me ato të vuemet e t’ua!

I t a l a –Edhe shum: mâ parë e me dalë qetsin e zemres.

A f r a – Po t’a xâ besë per hater.

¹ Instituti i Shkencave, Sekcioni i Gjuhës e i Letërsisë, Cipo, K – Çabej, E. – Domi, M.- Krajin, A. Myderrizi, O., Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.

I t a l a – Mandej fitoj meditime...

A f r a – Qi kam me t'u shpërblye atje mî rê, si knduen do vjershtarë t'onë...(Prej robnije në liri/f.8)

2. E trathtuemja

Na mjafton një replikë-tekst për të parë shumësinë e njësisë që po ndjekim në prozën e këtij shkrimtari, pikërisht në **Dukën e tretë** – *Lëna vetun* (akti III), f. 13-14: të dramës së parë (*Sjellë kahë vëndi kû pat dalë Elvira e tuj ju mâtë me shîs*)

“Po, moj, po! A kusuret veç? Posîiii ! Eja, eja, edhe një herë, se kusuret kam me diejt me t'i lã vetë “ (*Vjen në mjedis*). Uf-ooo ! Joo, kshtû së qitet mâ ! Jam bâ me dalë e me e lânë! Kjo shpî nuk â mâ shpî të kshtënësh, por vetë fundi i ferrit. Per deri tash vonë pûnët u dukshin fort per së marit, Por bâne e shîne mrëndë ket shtrigë, e pûna ka ndrue faqe; kjo asht tuej ja qitë temelin. Me ket gjarpnushë hîni edhe e zeza, pse ç'at ditë qi vûni kamë, nuk prâjnë ngatërresat, s'â kund gjâ per fije, posë njasajë pakice qi mundohem me ndreqë vetë. Kam bâ e nuk kam çilë gojë, nuk kam bâ zâ vetem pse drue se tash trishtohet ajo kercûnë zojë shpijet. Por prap, kuer t'a mendojsh, palla në thes nuk hînë e ka me ardhë dita, e drue, drue po tham, se më bîn ata gogët e mi e at herë nuk di se çka do të bâhet. Po kje qi më mërr neper kâmë edhe një herë, po kje qi më shàn, metsha qyqe në mos e bâsha hor; e at herë, por jo do të qes të gjitha të zezat e saja per fushë, a sè, në mos i pasha gjasë ksajë pûnë, një grusht hundve e buzve, sa me t'a bâ me ra fikët e në tokë. Kish t'a di pse nuk don me m' lânë mâ me hî n'odë të vet. A thue mos âsht tuj ngatrrue lâsha tjerë, per me rrênue Emen e shkretë? Hapi sýt, mori Lenë, e kija mëndt vedit, pse me ty nuk kâ luejt kush deri tash, kurrkush, jo...(Niset me dalë, por, tuj ardhë e zoja e shpis me turr, e ndalë.)”

Edhe nga nënvizimet bie në sy shpërndarja e njësisë frazeologjike, në gjithë sipërfaqen e tekstit, të cilat jo vetëm shfaqin karakterin e personazhit Lena, por edhe gjendjen shpirtërore, kulturën e saj dhe shkallën e marrëdhënieve me veprues të tjerë; mjaft prej tyre dalin sheshit nëpërmjet frazeologjizmeve dhe njësisë paremiologjike, të cilat po i analizojmë sipas radhës në monologun e zgjedhur këtu, që nga shënimi në kllapa i autorit, prej ku veçojmë: “tuj ju matë” – duke e kërcënuar; është një shkurtim i proverbit “*ma mirë me të rã, se me t'u mâtë*” – sepse të shkakton frikë të veçantë; bart kuptimin “bën sikur po të bie” me diçka; këtu: me fshesë në dorë!

- kusuret kam me diejt me t'i lã – laj kusuret, paguej reston; *nuk la gjë pa bërë, s'lë gjë pa i thënë* (FFGJSH/1999); përdoret në hapësirën e Veriut edhe “nuk i len kusur punës” – e bën cilësisht në shkallë të lartë, në atë mënyrë që, pas tij, s'ka njeri që të vërë dorë.

- nuk qitet – (vjen pa asnjë lidhje me kuptimin e parë “qes”, “shtie” diçka”, “fut” - folje përherë në trajtë mohore këtu, del me kuptimin “nuk kalohet”, “nuk është e mundur”, “nuk i dilet”, “nuk shtyhet” që lidhet me fjalë të klasave të ndryshme; prandaj dhe në hapësirën e Veriut, gjenden e përdoren:

- nuk qitet -

me të, me ju, kështu, në këtë mënyrë, me këtë kohë, me këto çmime...etj.

jam bâ me dalë e me e lânë – me tri folje radhazi; shpreh një

gjendje dëshpërimi, një gjendje të vështirë, kur njeriu s' di nga t'ia mbajë, nuk arrin të gjejë zgjidhje; në Shkodër, kjo frazeologji del edhe në trajtat:

- *jam ba me ikë natën* – *jam ba me ikë naten për hanë* – me qëllim që të mos e shohë a ndalojë njeri; ashtu si dhe: *jam ba me dalë e me ikë natën* – *jam ba me dalë e me ikë naten për hanë* !

- *ka ndrue faqe* – shprehja del e dykumtimitë– kuptimi i parë ka të bëjë me ndryshimin e një gjendjeje fizike a shpirtërore: nga mirë në keq, ose anasjelltas, ka ndërrue faqe jeta, ka ndryshuar për mirë, nuk jetojmë më si më parë; kurse, kuptimi i dytë lidhet me termin “breznî”, që, në të folmet popullore nënkupton një hark kohe prej rreth 25-30 vjet: *ka ndërue faqja, miku im* – ka ardhur një brez tjetër, jo si yni; krhs. *Ndërroi faqja e nierit* = u ndryshuan njerëzit në sjellje, mirëkuptim, marrëdhënie; por, në këtë hapësirë do të ndeshim edhe me kuptimin e tretë: ka ndërruar mendim, sjellje, “tabiat (tq.); edhe me një kuptim të sotëm: ka ndërue faqe – është bërë me një parti tjetër!!!

- *asht tuej ja qitë temelin* – i qes themelin një pune, një gjendjeje fizike: e shkatërroj prej sipërfaqes deri në themele, e shemb me kulm e themel.

- *ven kamë* – hyn brendë, zë e hyn, shkel fillimisht, nis e jeton në një vend; Krhs. Me “baj kamë” - veproj për herë të parë në një akt, baj kamë laknat me mish – vë për së pari, mish e lakna; sidomos thuhet pas Kreshmëve kur nuk konsumohet mish çdo ditë!

- *asht për fije* – shkon puna për fije, i ka punët për fije, zhvillohet mirë e mbarë, ashtu si duhet; zanafilla e shprehjes mund të ketë dalë nga veprimi duke formuar a duke çmbështjellë lëmshin me fije, sidomos në atë vend kur ngatërrohen fijet e perit dhe duhet t'i çmbështjellim apo kur shkon mbarë veprimi. Jashtë këtyre situatave, përdorimi del i figurshëm.

- *nuk kam çilë gojë* – nuk kam hapë gojë, nuk kam folur; edhe: nuk kam treguar një të fshehtë, një sekret, kam heshtur etj. edhe “nuk kam ditur të flas”, por edhe “nuk kam mësuar”, “s'jam përgatitur” etj.

- nuk kam ba za – formime me foljen “baj” + emra, si: **bâj** – zâ (bëzaj)

-fjalë (fjalosem), edhe: zihem.

-zhurmë (zhurmoj)

-hile (nuk gjeneron folje)

-kthesë (kthehem)

-pendim (pendohem)

-udhë (udhëtoj)

-drekë(drekoj;ha, përgatis)

-lutje (lutem), etj.

- *palla në thes nuk hînë* – një frazeologji e njohur në mbarë shqipen, por emri “pallë-a”, nuk i përket leksikut verior, pasi më së shumti përdoret fjala “shpatë”, që rrallë bëhet bazë e ndonjë frazeologjizmi, si: *asht shpatë nga goja, mos u ban shpatë në dorë të tjetrit*; apo në fjalën e urtë: *Kush ngre shpatën, prej shpates do të bjerë*. Kështu që në këto raste mund të pohojmë se edhe një krijues si Prendushi, del edhe përdorues i frazeologjizmeve edhe pse me termin “pallë-a” nuk njihet aq në folklorin e Veriut, me kuptimin: *nuk fshihet diçka e madhe, e dukshme, nuk mbulohet faji*.

- *më bîn ata gogët* – Çabej e shpjegon emrin “gogë-a” si “ofiç

i arumunëve e i shqeve ortodoksë; murator; njeri i trashë e i pagdhundur;...por historiani i madh i shqipës, prof. Çabej, te ky zë jep edhe sqarimin: “Gogët në etnografinë e Shqipërisë Veriore shfaqen si një fis i vjetër i zhdukur, që morën kuptimin e gjigantëve e të demonëve (i kan hî gogët). Khs. dhe *sinagog* ^[2].”

Në Veri, pra, përdoret në vështrimin e *dajvje*, ndaj dhe del më tepër si frazeologjizëm i shkurtuar, por në fakt nuk pengohet semantika e shprehur, sepse vjen e bëhet aq shpesh pjesë e gjuhës bisedore: “*as gogët nuk e mendojnë këtë; këtë e dinë vetëm gogët; e thonë edhe gogët*”.

- *mërr neper kâmë* – nëpërkëmb, poshtëroj, shtyp, dhunoj dikë, etj.

- *metsha qyqe në* - një mallkim; bart kuptimin “mbetsha vetëm”, “mbetsha pa njerz”.

- *mos e bâsha hor* – baj hor – shaj me të rënda, e bëj që të mos vlejë.

- *qes të zezat* - tregoj punët a veprimet negative që ka bërë dikush, të fshehtat.

- *qes per fushë* – i nxjerr haptas t’i shohin të gjithë; përdoret në Zadrimë edhe “mos e qit marrinë nëpër fushë”, ose “i del turpi nëpër fushë” = ia marrin vesh të gjithë, nuk ia mbaj të fshehtë asgjë, etj. Frazeologjizmi njihet prej kohësh dhe është regjistruar edhe në Fjalorin e Bashkimit, 1908.

- *me t’a bâ me i ra fikët e në tokë* – frazeologjizëm që shënon një dëmtim që i bëjmë dikujt: e rrahim, e rrëzojmë, e godasim në atë masë sa t’i bjerë të fikët e të rrëzohet.

- *ngatërroj lâsha* – bëj ngatërresa, prish një punë, qes fitme, nga: përziej fijet e lëmshit.


- *kija mëndtë vedit* – bëj kujdes, ec me mend kudo që të shkosh; del shpesh edhe “ku i ke lanë mendët?”

- *kam e krye* – shprehje e afërt me “ngatërroj lasha” – i bëj punët mbarë e mbrapsht, prish rregullin e rendin e gjërave.

- *i qes flutur në tru* – termi “flutur” këtu s’ka lidhje me insektin fluturues, por me një infeksion në mushkëri të deleve: “*kan delet flutur, kan xanë delet flutur*”; shprehja “*i qes flutur në tru*” del me kuptimin ia sëmur trurin, ia infektoj, i qes mërzi etj.

- *i perkas në tela* – e prek në tela, e ngacmoj në çështje delikate, ku nuk duron dhe reagon në mënyrat më të ashpra.

- *çart zemren* – i prish zemrën dikujt, e rëndo me fjalë a me vepra: “s’ma ka çartë kurrnjihërë zemrën ajo”. Me bazë emrin “zemër”, në veprën e Prendishut ndeshim një varg shprehjesh frazeologjike shumë të goditura të rrafshit popullor, por edhe për nivelin intelektual, siç është tuba e krijuar me këtë emër + folje të ndryshme:



² Çabej, Eqrem. Studime etimologjike në fushë të shqipës, IV, Dh-J, Tiranë, 1996, f. 270-271.

Kjo shumësi foljesh + emrin “zemër”, sjell nuancat e ndjesisë njerëzore, si pasojë e situatave të ndryshme të kumtimit a gjendjes shpirtërore, për pasqyrimin e të cilave del shprehja përkatëse. Pasuria apo gjenerimi i tyre, sipas disa studiuesve paremiologë ^[3] e frazeologë, në ndërtime si këto duhen vëzhguar kriteret leksikore, sintaksore e semantike. Autorët e cituar këtu *theksojnë se koncepti i metaforës është shumë i gjerë e mund të përfshijë tipologji shprehjesh*. Konkretisht, ata i vënë rëndësi *punës me lokucionet që përfshijnë në përbërësit e tyre një somatizëm* dhe që shprehin nocionet e trishtimit, gëzimit e dashurisë* ^[4]. Zakonisht gjuhëtarët sinkronistë, këto ndjeshmëri i shfaqin në çifte emrash, prej të cilave me folje e leksema të tjera gjenerohen shprehje frazeologjike, pra këta çifte i sjellin prej komuniteteve të ndryshme gjuhësore, siç kemi parë rastin e tyre me: *boca – bocca; brazo – braccio; cabeza – testa; corazon – curre; cullo - collo*, etj. Si shikohet, autorët e marrë si shembull vështrojnë çifte nga italishtja dhe spanjishtja, por për dialektet tona, mund të përqendrohemi tek dallimet e holla semantike midis foljeve që vihen në përbërje të shprehjve, për shembull, folja “brej” është më tepër një përdorim i variantit të Veriut; kjo është arsyeja që shprehja “më bren zemrën” ose “i bren zemrën”, gjeneron më dendur në hapësirat e gegërishtes, ndryshe, në shkrimtarinë e autorëve tanë. Pa u larguar nga emri i mësipërm “zemër”, gjuhëtarët që kemi mbështetur tek kjo paraqitje nga segmenti i vjelë në librin e cituar, kanë arritur në përfundimin se në teorinë e ligjëritimit figurativ konvencional, ndiqet motivimi ikonik dhe ai simbolik; i pari, në fakt, mbështetet në imazhet që evokojnë elementet leksikore të një frazeologjizmi, si në tubën e shprehjeve: *më mbushen sytë me lot – kam lot në sy; me veshët e rënë – me veshët e ulur*. Herë të tjera, sipas autorëve më sipër, motivimi simbolik, në të kundërt, del i markuar kulturalisht dhe mbështetet vetëm në njërin prej përbërësve të shprehjes së figurshme, pra te i ashtuquajturit simbol si: *zemër* që, për çdo qenie humane, është qendër e ndjenjave e cila gjeneron shprehje pa fund:

- *i vjedh zemrën dikujt* – *i dorëzoi zemrën dikujt* - *i jap zemrën dikujt*, etj ^[5]. Por edhe “i prek zemrën dikujt” (fig.); “i dridh zemrën dikujt”, “i zbut zemrën dikujt”, etj.

- *kso doret* – në këtë mënyrë: “pse flet kso doret, mori Emë?” Në dialektin e Veriut ngjet që të njihemi me të ashtuquajturin *ndërtim enumerativ* të foljeve, të përdorimit të dy a më tepër foljeve radhazi, dukuri që e mësojmë këtu e para më se 80 vjetëve nga gjuhëtari e gramatikani Justin Rrota, i cili, në përmbledhjen me studime “Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore”, besoj të jetë i pari e i vetmi gjuhëtar që na bën të njohur këtë dukuri si përkatësi e të folmeve të gegërishtes – praninë e *endiadave* – të cilën gjuhëtari ynë e shpjegon si vijon: “*Në dëshirë Shqiptari, që t’a shprehë sa ma fortë, të qartë e të pikatuni një veprë, posaçë poeti i popullit, kahë s’i duket mjaft një verb, shkon e i shton këtij për bri edhe një tjetër, me kuptim thuasje gati sinonim me të. Këjo mënyrë*”

³ Martinez de Cornero Calzada, Fernando - Fajardo, Luisa A. Messina, Studi di fraseologia e paremiologia – I, Roma, Settembre, 2015, p. 41.

⁴ Po ata, po aty, f. 41.

* termi *somatik* (somatico) është term i fushës së biologjisë dhe i referohet trupit të organizmave të gjalla; ashtu si ka edhe referim me trupin e njeriut, për tiparet e karakteret somatike të një race apo të një individi.

⁵ Po ata, po aty, f. 44.

përsëritjesh së verbit quhet ndertim enumerativ ^[6]. Prandaj dhe përgjatë dramatikës së këtij shkrimtari françeskan ndeshim: *m'u dha me ndejë, u vuna me u lutë, me çue me lypë, m'jepet me përbuzë*, etj., të cilat, në kontekste të plota tërheqin vëmendjen dhe kthehen në struktura frazeologjike.

E sollëm këtë shfaqje gjuhësore për faktin se dukuria e përshkruar këtu, ka raste që del si përbërës edhe në strukturë të frazeologjizmave, siç kemi ndeshur këto në vijim:

- *bâne e shtëne* – bane e e shtine n'shpi ket...- merr edhe kuptimin kushtor: po guxove, po të shko mendja, me e shtie, etj.

- *më bahet me xanë besë* – më vjen me e besue diçka për të vërtetë; më duket...etj.

- *me bâ me marrë vesh* – me ba me e marrë vesh ma mirë, se sa në gabim je,...del qartë

shprehja e kushtit “me ba me dëgjue”, “nëse dëgjoj” për një veprim a punë, a fjalë, etj.

- *shend e verë* – frazeologjizëm tipik i gegërishtes, mjaft i përdorshëm edhe në gjuhën e shkruar, që paraqet një gjendje gëzimi: “shend e verë nieri nuk mundet me kenë gjithmonë”.

- *me ra në fije* – kam uzdajë se nuk ka me vonue shumë e ka me ra në fije (f. 21)- kam shpresë se nuk ka me vonue shumë e ka me ardhë në rrugë të mbarë, ka me u kthye në udhë të drejtë: një formim me folje në të ardhmen e largët, që e merr shkasin prej shtjellimit të fijes së perit nëpër lamsha. Me vlerë të së ardhmes, vjen edhe paskajorja geqe, që e përdor Prendushi “*me pasë për të thanë*” (f. 23).

Ndonjëherë, në grupin e madh të frazeologjizmave, dallojnë ato që janë karakterizuese të personit, si “*faqja e zezë*” – asht – bart kuptimin dashakeqës për një njeri faqezi, të padëshiruar; “*dorë të keqe*” – ka – e të tjera, të cilat dalin në segmente fjalish a thëniesh të tilla, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar; kjo e dyta, ka lidhje me hajninë (vjedhjen), siç radhitet këtu edhe “*faqe e ngritë*” – që s'luan, nuk ndryshon, por rri si e ngrirë.

- *shkon mâ zi* - thuhet për një punë, veprim, përshtkrim, etj. A ka ku shkon ma zi?

- *i vjen e mbramja* – zakonisht del si parashikim i dëshiruar për një person keqbërës, bile në Shkodër, dëgjohet edhe “*i vjen e mbramja me samar*” – çka do të thotë se i vjen fundi i jetës, duke u ngarkuar si gomar, si kal; i vjen fund i keq: nuk duhet harruar as aforizmi “*tue u plakë e tue iu shtue puna*”, e cila lidhet kuptimisht me atë më sipër. Përdoret edhe me vlerë fjalie në strukturë fraze: *S'i dihet si të vjen e mramja* – s'i dihet si të vjen fundi i jetës.

Ka disa formime shprehjesh me fjalën “pikë”, zakonisht si shënime për kohën, si:

- *në pikë të mesnatës - në pikë të mesditës - në pikë të dimnit - në pikë të hallit - në pikë*

⁶ Rrota, Justin, Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, Botim I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 405. (Më tej autori i këtij botimi postum, sqaron: “*Rapsodit tona klasike janë plot me këso ndërtime të enumerative ase endiadesh. Qe, këtu një dorë shembujsh së huajturë nga goja e popullit: - Bana e i a përmena. U vu e i a njëti të gjitha një kahë një. E varra atij të shkretëtirë erdh e i u ajë e i u bâ mal. Gjaksi atbotë, marrë mëç prej friket, voji e hini fill e në shtëpin e të vramit. Ti ulu një herë e rri. Shkon e m'i klaxon atij: ani kuj mandej! E ai vjen e më thotë...Unë s'po hi me rendue këtu të tana. Ai u çue e shkoi. Edhe kështu a i shuemi diq e mbaroi. - “Ka qitë Muji e ka thanë”. “Kanë marrë rrugën e janë nisë”. “A dredhë, krajllit i ka thanë.”- Edhe Budi ka gjithkund formulën tipike, me të cilën u përgjegjë pyetjeve të katekizmit: “E xhakoni mbet e i tha”... (f. 405)*

të vapës, në pikë të nadjes, në pikë të natës, etj.

- *më ndien zemra* – ma thotë zemra, parashikoj një gjë para se të ndodhë, për diçka të mirë ose jo të mirë.

Me shprehjet frazeologjike duhen renditur tek vepra e Prendushit edhe “*them uratë*” – lutem; “*sahat e ma parë*” – sa më shpejt; “*kâm e në dorë*” – me të shpejtë, pa ndërprerje; “*kam droje*” – kam frikë, frikësohem; “*me lott për faqe*” – duke qarë, me dhimbje; nuk mundem me harrue një vajzë të mjerë që shtyn kashaten me lott në sy (f. 34)

- *i pakon fijen e jetës* – i pakëson vazhdimësinë (fijen) e jetës; i shkurton ditët;

- *i bie në erë* – e nuhat, e parasheh një punë apo ngjarje që po ndodh apo do të ndodhë;

- *dorë e keqe* – dorë që prej gjërat e të tjerëve, dorë që vjedh = ka dorë;

- *e gërmon diçka* – e nxit, e shtyn, e ngacmon për të kryer një veprim (“çka të gërmon me e shty ktej pri);

- *bindet dheu në ty* – habitet dheu (bota) në ty = për veprime e sjellje tuaja;

- *flet pa perde* – flet drejtpërdrejt, pa u fshehur pas fjalëve me nënkuptime: “me të thanë ashtu pa perde...”;

- *nuk të qet në treg* – nuk të ndihmon, nuk arrin asgjë: “nuk qesin gja në treg”, nuk arrijnë asgjë;

- *del për fushë* – “të del për fushë pafajnia jote”= del në pah, del në dritë që ta shohin të gjithë, pa pengesa;

- *i bie mohit* – “i bie mohit familjes” = po mohoj familjen;

- *baj me dije* – njoftoj, lajmëroj;

- *këput e mbaro* – mos diskuto më tepër: “...paskam kenë fajtoare e këput e mbaro”;

- *si një herë përherë* – vazhdimisht, pa ndërprerje;

- *kalon e tretë* – e lënë mendët apo i tresin mendët; “Kur vjen ndonjëherë në vedi, lutet e kjan, por mandej kalon prap e tretë, tue folë gjithë kohen në kllapi” (f. 72);

3. Prej robniqe në liri

Është vepër origjinale e autorit, shkruar 11 vjet më vonë (1931) se drama tjetër dhe e vënë në skenë disa herë nga shkollat e ndryshme të qytetit, nga e cila po zgjedhim disa frazeologjizma, pa lënë jashtë ndonjë aforizëm paremiologjik a fjalë të urta, për të cilat mendojmë se nuk i kemi ndeshur deri më tani gjatë punës sonë:

- *vrae guri* – një mallkim i lehtë, si: *vraje Zot, vraje Zanë, vraje Fat*, etj., e cila vjen si e kohës parakristiane: “..kishte me kenë ma koha, he vrae guri, pse qysh se...” Shënojmë se mallkimet që ndeshim tek vepra letrare e këtij autori, diferencohen jo vetëm nga afëria gjinore (të afërtit mallkohen më lehtë se të tjerët më larg gjinisë), si nga statusi i vetë krijuesit Prendushi, që ishte klerik dhe, domosdo, nuk përdor mallkime të skajshme, si, bie fjala prej atyre që përmbajnë termat “dreq”, “djall”, “Lucifer”; në vend të dytë mund të dalin ato me emrat “shtrigë”, “shtrigue”, “hider”, e mjaft të tjera që mund t'i kishte vepra letrare e një laiku.

- *ve ujët në zjarm* – frazeologji me vlerë fjalie, që bart kuptimin “kam ndër mend diçka”, kam planifikuar për punë në të ardhmen, është një detyrim për folësin, etj. Nuk mund të shmangeshin qindpërqind frazeologjizmat me ndonjë përbërës

fjalë turke, në kohën kur krijonte Prendushi e të tjerë shkrimtarë, sepse në atë periudhë ato njiheshin prej popullit, prandaj dhe gjejmë aty-këtu, si:

- *me ju ba hallall* – (me një emër tq.), cilën po e sjellim me kuptimet që i jep kësaj shprehjeje T.Dizdari, autori i Fjalorit të orientalizmeve në gjuhën shqipe^[7]. *gja e drejtë dhe e lejueshme në çdo marrëdhënie (nga ana e fesë) legjitime: meritim, e drejtë, hir; antonimi: haram*^[8].

- *me duer n'î* - (î-ja e gjatë hundore shënon belin, vendin ku vëmë duart kur nuk punojmë, ose kur pushojmë; shprehja “rri me duer n'î” bart kuptimin “rri kot së koti”, pa asnjë punë a aktivitet; *na shkon moti tue u tallë* – shkruan Prendushi (f. 7).

- *çoj vnerin dikujt* – frazeologjizëm mjaft i rrallë me përdorim në popull, që ka kuptimin “e bëj me vjellë”, i sjell neveri në atë masë, sa t’i provokohet të vjellët; mos na çoj vnerin me ato fjalë, në rastet kur para dikujt përshkruajmë ngjarje a fakte të neveritshme:

- *më vjen ujë në mulli* -.kish të më vîte një herë ujët në mullë – më vjen radha e një të drejte, e një mundësie për diçka; thuhet sidomos për hakmarrje ndaj dikujt; burimi i këtij frazeologjizmi vjen prej rregullit të prerë e aq fort të zbatueshëm për radhën e ujit të vaditjes, por edhe në mullinj, kur ata ishin varg e bluanin me radhë.

- *bluej trashë* – një shprehje e rrafshit bisedor që përdoret rrallë në gjuhën e shkruar dhe ka kuptimin “flas la e pa la” – flas pa finesë; përdor fjalë e shprehje të rënda, me fjalë tepër të papastra = bluej trashë. Autori e sjell të shformuar, në të njëjtën replikë ku ndodhet edhe frazeologjia e mësipërme, mbase për shkak të theksimit: *...kisha me pa edhe ti se sa trashë kishem me diejtë me blue*.

- *bie shpirtin në fyt* – shprehje sinonime me “na pru shpirtin me dalë” – na mundon rëndë, na shfrytëzon deri në palcë, na nxjerr shpirtin; në disa krahina e të folme, si për shembull, në Malësi të Dukagjinit, njihet edhe formulimi “*shpirt ku s’del*”, për të karakterizuar një punë tepër të rëndë, të pamundur dhe antinjerëzore, punë të mundimshme, ndaj së cilës reagohet ashpër.

- *xëj kryet* – zakonisht në trajtë mohore: nuk e xëj kryet, nuk çaj kokën për një punë, nuk shqetësohem fare, në korrelatë nga kuptimi me “*s’e vë ujët në zjarm*”, që sollëm më sipër.

- *jap gjygj*- gjykoj, shpreh një mendim, “s’jam e zoja me dhanë gjygj për këto punë...”

- *shef veç drandofille e s’din se sa ferra kan* – karakterizim i figurshëm për një njeri që shikon vetëm anët e lehta e të bukura të jetës, pa njohur vështirësi e mundime.

- *ka me sharrue* – frazeologjizëm me vlerë fjalie, ku theksimi bie mbi foljen “me sharrue” e cila s’ka asnjë lidhje me veprimin e prerjes me sharrë, por figura mbi këtë emër ndërtohet; në hapësirat e Veriut përdoret me kuptimin “ka me mbarue”, “ka me mbyllë jetën në skamie e mjerim. (f.24).

- *t’kotullon gjumi* – folje dialektore, jo aq e njohur; del me kuptimet: kotesh, dremit, po të këput gjumi, por të vjen gjumi, po të merr gjumi: *sa herë qi ditën e kotullote gjumi, mërrshin*

⁷ Dizdari, Tahir: **Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe**, Tiranë, 2005.

⁸ Po ai, po aty. (Më tej orientalisti i nohur leksikograf vazhdon: *Me dhanë, me marrë hallallin – të hjekurit dorë prej të drejtave morale e e materiale ndaj tjetrit*, *Hallalli i mramë, hallalli i fundit. Në një proverb thuhet “Në hallall ka shejtani gjysem, në haram ka gjan e t’zonë”*; ose: “*Ma mirë një pare hallall, se tridhet qese haram.*”; “*Para se të vdiste u dha hallallekun t’bijvet*”, etj.)

me i bertitë (f. 25) e mjaft të tjera të kësaj natyre.

- *po të kungoj me këtë* – një shprehje që ka në përbërje foljen e leksikut fetar “kungoj”, prej së cilës rrjedh edhe emri “kungatë-a”, s’ka asnjë lidhje me ndonjë proces a akt besimi a praktike të tij, por pasqyron një skenë familjare: një nënë që ushqen fëmijën e saj me diçka krejt të vogël a të paktë, ashtu siç është ostja që jepet kur meshtari jep kungatën të rrëfyerit – bart kuptimin “po të ushqej me pak, me diçka jo të rëndë”, etj.

- *zbloj mendimin* – kuptoj, mbërrij deri te e fshehta e mendimit të dikujt;

- *janë bukë e përditshme* – janë të zakonshme, si buka që hamë çdo ditë;

- *“bukën tonë të përditshme jepna sot”* –, me tingëllim të njohur biblik. Del dendur në ligjërimin bisedor edhe frazema “*është bukë e djathë*”- me kuptimin e një diçkaje, a pune të thjeshtë, që e dimë ta veprojmë; edhe:

- *“si buka që hamë”* – për të pohuar një të vërtetë, që e dimë të gjithë.

- *ia baj vedit livadh – i shtroj livadh vetes* - ia bëj vetës të lehtë një punë, lehtësoj, harroj vështirësitë; sinonime me këtë del edhe:

- *ia ban vetes sapun kudo shkon* – ia lehtëson së tepërmi një punë a vështirësi.

- *e pau mâ me udhë* – e pau ma të drejtë diçka: veprim a gjendje;

- *i njis dorën* - i ngjis dorën, e ndihmoj, i jap dorën, i jap ndihmë dikujt për diçka;

- *i jap vedit* – përpiqem, dal në dukje; edhe “*mbahem me të madh*”- krenohem pa meritë;

- *m’mbushet mendja* – bindem për diçka; - *i mbushet mendja top; e ka mendjen top për një punë*. Por “*e ka mendjen top*” bart edhe kuptimin: *e ka mendjen të freskët*, është në gjendje mendore normale, me gjithë moshën. Vetëm me emrin “bukë” vjen e krijohet një numër frazeologjizmesh, disa prej të cilave nuk dëshmohen në FFGJSH:

“bukë “

“është bukë e djathë” – “është bukë e pjekur” – “është bukë e përditshme”

– “është bukë e papjekur” –

“është bukë e ndrequr” – “është punë pa bukë” – “punë që të jep bukë”

– “është shtëpi buke” –

“buka nuk humb” – “s’harrohet buka” – “është bukë e dhanme”

– “është në bukën tonë” –

“e preu në bukë” – “është në besë buke” – “i shtroi bukë”

– “i flas në bukë” –

“buka nuk shahet” - “ha bukë të mëndafshhtë”- (edhe “e han të mëndafshhtë”)

– “e vret buka” –

“ndaj bukën me të” – “bashkoj bukën me dikë” – “kemi bukën bashkë”

- *han turpin me bukë* –
- *han marren me bukë* -

4. Përfundime

Punimi i sjellë më sipër na çon në përfundime të natyrës formale dhe semantike lidhur me dukurinë e dendurinë gjuhësore të frazeologjizmave në prozën e Prennushit:

1. Jemi të vetëdijshëm që edhe brenda krijimtarisë së këtij autori, nuk mund të kemi prani të njëjtë, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, të këtyre njësisve leksikore.
2. Ndikuar nga faktorë, si: koha, mjedisi ku lindi e u rrit, arsimimi dhe statusi prej kleriku i autorit, shprehjet frazeologjike dhe paremiologjike në dy vepra dramatike që sollëm këtu, themi se dëshmojnë për mjaft veçori në llojin e tyre duke dhënë kështu koloritin e kohës e të vendit.
3. Në vështrimin etnolinguistik e psikën e personazheve, kulturën dhe portretin moral të tyre, njësitë frazeologjike shprehin edhe gjendjen sociale dh statusin intelektual të personazheve që i përdorin.
4. Përgjithësisht, frazeologjizmat tek këto dy drama janë përfshirë në indin e frazave, pa shformime që pësojnë këto njësi në strukturën e poezisë.
5. Themë se shkrimtari V.Prendushi, që njihet edhe si mbledhës i folklorit të trevave të Veriut, e ka njohur mirë visarin popullor të leksikut e në veçanti frazeologjinë e tij.

Referencas

1. Calzada, Fernando Martinez de Carnero & Fajardo, Luisa A. Messina, Studi di Frazeologjia e Paremiologia, Università degli Studi *Roma Tre*, Aracne Editrice Srl – Roma, 2015.
2. Çabej E. Studime etimologjike në fushë të shqipes, IV, Dh-J, Tiranë, 1996.
3. Dizdari T. Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005.
4. Institui i Shkencave, Sekcioni i Gjuhës e i Letërsisë, Cipo K, Çabej E, Domi M, Krajni A, Myderrizi O, Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954.
5. Prennushi V, OFM E. Trathtuemja-Dram pësë veprimesh, Shtypshkroja Franciskane, Shkoder, 1919.
6. Prennushi, V. O.F.M. Prej robnije në liri–Dram 5 veprimesh, Shtypshkroja Franceskan, Shkoder, 1931.
7. Rrota J. Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore, Botim I, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.